



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS LIPJAN

Numri i lëndës: 2025:023308

Datë: 11.02.2025

Numri i dokumentit: 06835512

P.nr.35/25

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË- DEGA NË LIPJAN, në përbërje prej gjyqtarit të vetëm Selman Salihu, me pjesëmarrjen e bashkepunetores profesionale Vesa Bajrami duke vendosur në lëndën penale kundër të pandehurit L. H. nga fsh.G. e E. K.L., të cilin e akuzon PTH në Prishtinë, me aktakuzën e saj PP.II.nr.5426/24 te dt.06.02.2024 për shkak se ka kryer veprën penale Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par.1 të KPRK-së, duke vendosur lidhur me kërkesën e PTHP-së, për dhënien e urdhrin ndëshkimor, me datën 10.02.2025 merr këtë:

A K T G J Y K I M

PRANOHET kërkesa e PTH-së në Prishtinë PP.II.nr.5426/24 e dt.06.02.2024, dhe kjo gjykatë jep këtë:

URDHËR NDËSHKIMOR

Kundër të pandehurit:

L. H., i lindur më dt...., në P., nga i ati B. dhe e ëma H., mbiemri i vajzërisë së nënës R., me vendbanim në fshatin G. e E., komuna e L., me numër personal ..., moler, ka kryer shkollën fillore, i pa martuar, i gjendjes së mesme ekonomike, Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës.

Ë S H T Ë F A J T O R

SEPSE:

Me datë 28.05.2024 në shtëpinë e tij në fshatin G. e E., pa autorizim ka poseduar substanca narkotike, të cilat ia ka gjetur Policia e Kosovës kur ka shkuar në shtëpinë e tij për shkak rastit dhunë në familje, ashtu që kur ka ardhur policia e ka kontrolluar të dyshuarin dhe ka gjetur një qese në të cilën ka qenë substanca narkotike për të cilën në bazë të Raportit të Agjensionit të Kosovës për Forenzikë numër AKF/2024- 2360/24-2254 prej dt. 07.08.2024, me ekspertizë është vërtetuar që është e llojit Kanabis (Marihuanë) i cili përbënë Tetrahidrokanabinol (THC) me peshë të përgjithshme 0.65 ± 0.0001 gram;

- Me këtë i pandehuri ka kryer veprën penale Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par.1 të KPRK-së.

Andaj gjykata, konform dispozitave të neneve, 1, 2, 4, 6, 7, 17, 21, 38, 39, 40, 43, 69, nenit 269 par.1 të KPRK-së, neneve 493, 495 dhe nenit 365 të KPPRK-së, të pandehurin e,

G J Y K O N

Me dënim me gjobë në shumë prej 400-€, të cilin dënim i pandehuri është i obliguar që ta paguaj, në afat prej 15 dite pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, në rast se dënimi nuk realizohet as me detyrim, gjykata dënimin me gjobë do ta zëvendësojë me dënim me burgim, konform nenit 43 par.3 të KPRK-së, ashtu që për çdo ditë të kaluar në burg, të llogaritet shuma prej 20-€.

OBLIGOHET i pandehuri që kësaj gjykate në emër të paushallit gjyqësor të ia paguaj shumën prej 30-€, si për kompensimin e viktimave të krimit shumën prej 20-€ pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm, në afat prej 15 dite nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi.

Konfiskohet substanca narkotike e llojit Kanabis (Marihuanë) e cili përbënë Tetrahidrokanabinol (THC) me peshë të përgjithshme 0.65 ± 0.0001 gram;

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë me aktakuzën e saj PP.II.nr.5426/24 të dt.06.02.2024, e ka akuzuar të pandehurin L. H. nga fsh.G. e E. K.L., për shkak të veprës penale Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par.1 të KPRK-së, dhe në të njëjtën datë ka kërkuar që të pandehurit ti shqiptohet urdhër ndëshkimor për veprën e lartëshënuar penale.

Gjykata duke analizuar aktakuzën, si dhe kallëzimi penal me nr. të rastit 2024-AH-0595 të dt. 14.10.2024, raporti i policit hetues i dt.28.05.2024, raporti fillestar i incidentit i dt.28.05.2024, procesverbali i marrjes në pyetje për të dyshuarin i dt.28.05.2024, procesverbali i dëshmisë/pronës i dt.28.05.2024, foto, raporti i ekspertimit i dt.07.08.2024, si dhe shkresave tjera të lëndës konstaton se ka prova të mjaftueshme në drejtim të vërtetimit të fakteve se i pandehuri vërtetë ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet, prandaj gjykata të njëjtin e shpalli fajtor dhe e gjykoj si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Me dispozitën e nenit 493 të KPPK-së parashihet se “Për vepra penale e cila parashihet dënimi me gjobë ose burgim deri në 3 (tre) vite, për të cilat prokurori i shtetit është i informuar me provat e besueshme nga kallëzimi penal, prokurori i shtetit mund të kërkoj në aktakuzë që gjykata të jep urdhër ndëshkimor, në të cilin të akuzuarit do ti shqiptoi dënim përkatës pa e mbajtur shqyrtimin gjyqësor”.

Gjyqtari me rastin e shqyrtimit paraprak të çështjes konform nenit 493 të KPPK-së, gjeti se janë plotësuar kushtet për shqiptimin e urdhrit ndëshkimor ndaj të akuzuarit nga arsyet se dënimi për veprën penale me të cilën ngarkohet i akuzuari është dënim me gjobë ose me burgim deri në 3 (tri) vite, andaj gjykata konform dispozitave të lartcekura vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimi për shpenzimet e procedurës dhe paushallit gjyqësor u bazua konform nenit 450 par. të KPPRK-së, ndërsa vendimi për kompensimin e viktimave të krimit u mor në bazë të nenit 36 par. 3 pika 3.1 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Vendimi mbi konfiskimin u mor konform nenit 269 par.3 të KPRK-së.

Nga arsyet e cekura më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË- DEGA NË LIPJAN

P.nr.35/25, me dt. 10.02.2025

Bashkëpunëtorja profesionale

Vesa Bajrami

GJYQTAR

Selman Salihi

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë në kundërshtim në afat prej 8 (tetë) dite nga dita e marrjes së të njëjtit, kundërshtimi i drejtohet gjyqtarit individual të kësaj gjykate.